



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
ZV/KRYETARI

Nr. 149 Prot.

Tiranë, më 21/01/2020

URDHËR

Nr. 20, datë 21.01.2020

PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË
ADMINISTRATËS GJYQËSORE TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 13/2 të ligjit nr. 98/2017 "Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë", të neneve 26/2 dhe 37/dh të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 105 të K.Pr.Penale dhe nenit 77 të K.Pr.Civile, si dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare",

URDHËROJ:

1. Tarifatat për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë, caktohen sipas Lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij Urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Agjent për mbledhjen e tarifave për kryerjen e veprimeve të shërbimeve administrative në Gjykatën e Lartë, caktohet administrata e Gjykatës së Lartë.
3. Mbi bazën e kërkesës së personit të interesuar, sekretaria gjyqësore në bashkëpunim me sektorin që mbulon marrëdhëniet me publikun, procedon për gjetjen e dosjes gjyqësore dhe riprodhimin e aktit të kërkuar, sipas rregullave të këtij Urdhri.
4. Tarifatat parapagohen nga kërkuesi me anën e pullës sipas tarifave fikse për dokumentet e lëshuara ose me faturë / mandat arkëtimi për rastet e fotokopjeve të akteve të dosjes gjyqësore.
5. Pullat vendosen në çdo kopje të dokumentit të lëshuar, për të gjitha dokumentet që, sipas ligjit, duhet të pajisen me pulla. Dokumentet janë të vlefshme kur pulla është e vulosur me vulën e Gjykatës së Lartë.
6. Në rast se personi kërkon fotokopje të akteve të dosjes gjyqësore që ndodhet në Gjykatën e Lartë, vlera e tarifës është sipas Lidhjes nr. 1, me kusht që tek akti ose dokumenti të jetë shënuar fjala "kopje".
7. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve të shërbimeve administrative në Gjykatën e Lartë.

8. Për vjeljen e tarifave me anën e pullës, Gjykata e Lartë planifikon dhe porosit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve sasinë e pullave sipas nevojave.
9. Mbi tarifën e shërbimit të përfshira në këtë Urdhër nuk aplikohet TVSH-ja.
10. Këto tarifa aplikohen në çdo rast pavarësisht tarifave të shërbimit, të parashikuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore.
11. Sektori i Financës së Gjykatës së Lartë detyrohet:
 - a) të bëjë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklaratimet;
 - b) të paguajë për llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore tarifën kombëtare të arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës;
 - c) të bëjë dhe të dorëzojë deklaratën në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet në aktet ligjore e nënligjore përkatës në fuqi;
 - d) të raportojë në Këshillin e Lartë Gjyqësorë masën e shumavë të arkëtuara nga aplikimi i tarifave në Gjykatën e Lartë.
12. Ky Urdhër të publikohet në ambiente të dukshme të Gjykatës së Lartë dhe në faqen zyrtare të saj.
13. Ngarkohen strukturat e Gjykatës së Lartë për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi me datë 01.02.2020.

ZËVENDESKRYETARI

ARDIAN DVORANI



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp is blue and contains the text 'REPUBLICA E SHQIPËRISE' at the top, 'GJYKATA E LARTË' at the bottom, and 'GJYKATA E LARTË' in the center. The signature is written in a cursive style and overlaps the stamp.

Lidhje nr. 1

**TARIFA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA
GJYQËSORE E GJYKATËS SË LARTË**

A.	Tarifa për veprime e shërbime të administratës gjyqësore	Masa e tarifës
1.	Kërkesë për konstatimin e shkeljes se afatit të arsyeshëm	200 lekë
2.	Kërkesë për pezullimine ekzekutimit të vendimit	200 lekë
3.	Kërkesë për revokimin/ndryshimin e vendimit te pezullimit te ekzekutimit të vendimit	200 lekë
3.	Rekurs, shtesë në recurs, kundërecurs	200 lekë
4.	Kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit	200 lekë
5.	Kërkesë për përjashtim të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes	200 lekë
6.	Kopje vendimi gjyqësor që kërkohet nga të interesuarit	200 lekë
7.	Kopje për cdo akt procedural të dosjes gjyqësore	200 lekë
8.	CD e procesverbalit gjyqësor të Gjykatës së Lartë	200 lekë
9.	Lëshim vërtetimi se kërkuesi është (nuk është) në proces gjyqësor	200 lekë
10.	Dokumenta të tjera	200 lekë